VENDIM
Nr.808, datë 4.12.2003

PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT

(Ndryshuar me VKM nr. 736, datë 1.7.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me *dëshmi aftësie.*

2. Shfuqizuar.

3. a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënien e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.

b) Kushtet dhe kriteret për dhënien e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. *Kurset teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij vendimi.*

5. *Shfuqizuar.*

6. Përdorimi i makinerive të rënda pa lejen e manovrimit përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano